


Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

**SHEJH ABDULFETTAH KADI EL-
EZ'HERIU DHE KONTRIBUTI I TIJ NË
ZHVLEFTËSIMIN E AKUZAVE TË
ORIENTALISTIT IGNAZ GOLD TSIHER
NDAJ KIRAETEVE**



Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

**SHEJH ABDULFETTAH KADI EL-EZ'HERIU DHE
KONTRIBUTI I TIJ NE ZHVLETESIMIN E AKUZAVE TE
ORIENTALISTIT IGNAZ GOLD TSIHER NDAJ
LEXIMEVE KUR'ANORE**

Përktheu:

Sedat ISLAMI

Dr. Hajredin HOXHA

**SHEJH ABDULFETTAH KADI EL-EZ'HERIU DHE
KONTRIBUTI I TIJ NE ZHVLETESIMIN E
AKUZAVE TE ORIENTALISTIT IGNAZ GOLD
TSIHER NDAJ LEXIMEVE KUR'ANORE**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës. Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmimin e kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake me shkrim të autorit.

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:

Sedat ISLAMI

Recensent: Ajni Sinani

Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani

Titulli në origjinal:

Dr. Hajruddin Huxheh, *Xhuhudu-sh-Shejhi Abdul Fettah el-Kadi el-Ez'herijj fi hidmeti-d-dirasat el-kur'anijjeh ve-d-difaë anil kiraat dide metainil-musteshrikine,*

referim shkencor në Seminarin Ndërkombëtar “*El-kiraat vel-kurr-rra*”, të organizuar nga Universiteti Zejnul Abidin në Terengganu, Malajzi, 29-30 tetor 2010.

Dr. Hajredin HOXHA

**SHEJH ABDULFETTAH KADI EL-EZ'HERIU DHE
KONTRIBUTI I TIJ NE ZHVLETESIMIN E
AKUZAVE TE ORIENTALISTIT IGNAZ GOLD
TSIHER NDAJ LEXIMEVE KUR'ANORE**

بسم الله الرحمن الرحيم

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Përmbajtja:

Hyrje

I: BIOGRAFIA E SHEJH ABDUL FETTAH KADIUT

1. Letërnjoftimi i shejhut

1.1 Të dhëna për jetën e tij

1.2 Hoxhallarët e tij

1.3 Shkollimi

1.4 Nxënësit e tij

2. Pozita e tij shkencore dhe postet të cilat ushtroi

2.1 Veprat e tij

2.2. Pozitat dhe funksionet që ushtroi

2.3. Sinqeriteti i tij në mësimdhënie dhe sekretet e suksesit të tij

3. Vdekja e tij

II. KONTRIBUTI AKADEMIK I SHEJH ABDUL FETTAH EL-KADIUT NË FUSHËN E MBROJTJES SË LEXIMEVE DHE STUDIMEVE KUR'ANORE

1. Mësimdhënie, në formën klasike dhe bashkëkohore

2. Angazhimi në projektet kur'anore, që konsiderohet si një ndër sukseset kur'anore me ndikimin më të madh në kohën tonë

3. Shkrimet

III. AKUZAT E GOLDZIHHERIT NDAJ LEXIMEVE KUR'ANORE DHE ZHVLEFTËSIMI I TYRE NGA ANA E SHEJH ABDUL FETTAH KADIUT

1. Dyshimi i parë dhe demantimi i tij

2. Dyshimi i dytë dhe zhvleftësimi i tij

3. Dyshimi i tretë dhe zhvleftësimi i tij

Përfundim

Literatura

Hyrje

Falënderimet i takojnë Allahut!

Përshëndetjet qofshin për zotërinë e njerëzimit, Muhammedin, familjen, shokët dhe të gjithë pasuesit e tij!

Ky punim, në të vërtetë, është një referim shkencor i përgatitur për t'u mbajtur në Seminarin Ndërkombëtar në Terengganu, Malajzi, përkitazi me lexuesit dhe leximet e Kur'anit (*Kiraat and Kurra*). Tematika e seminarit është jo vetëm e qëlluar, por dhe shumë e rëndësishme për shkak të anashkalimit dhe neglizhimit të saj, madje edhe nga dijetarë dhe hoxhallarë të mëdhenj. Nuk ka dyshim se interesimi dhe dhënia pas shkencave të Kur'anit është puna më e mirë e mundshme që bëhet, për shkak se vlera dhe rëndësia e tyre burojnë nga vetë vlera dhe rëndësia e librit që studiohet, pra Kur'anit Famëlartë.

Tema dhe kapitulli i *kirateve* (leximeve të Kur'anit) nuk u neglizhua edhe nga armiqtë, të cilët, si në të kaluarën si në të tanishmen, nuk iu qasën studimit të tyre pse e duan Kur'anin dhe duan ta mbrojnë atë, por për shkak se, meqë shkencën e kanë vënë në shërbim të qëllimeve dhe aspiratave imperialiste dhe kolonialiste¹, duan shtrembërimin e tij, hedhjen e dyshimeve mbi të, uljen e vlerës së tij etj., vetëm e vetëm që të sundojnë në tokat e muslimanëve dhe të përvetësojnë pasuritë e tyre, si dhe të hedhin dyshime mbi Kur'anin Famëlartë². Ishin orientalistët ata që e morën përsipër këtë detyrë të marrë dhe këtë mision të ndyrë, në mesin e të cilëve më të njohurit ishin: Maxim Rodinson, Montgomery Watt, Blachaire, Ignaz Goldziher, Rodensoni, Dunckan Black MacDonald etj³.

¹ Shih: Al Humejd, Sa'd. *Ehdafu-l-istishraki ve vesailuhu*, f. 5-15.

² Shih: Ebu Shehbe, Muhammed. *Difaun ani-s-Sunneti ve reddu shubehi-l-musteshkrikine ve-l-kuttabi-l-muasirine – ve jelihi err-rreddu ala men junkiru huxh-xhijjete-s-Sunneti li-l-Al-lameti Abdul Gani Abdul Halik*, f. 10-50.

³ Shih: Xhebel, Muhammed Hasen Hasen. *Err-rreddu ala el-musteshkriki el-jehudijj xhuldztsiher fi metainihi ala el-kiraati-l-kur'anijeh*, f. 12-70. Prof. Muhammed Haseni ia ka arritur me sukses që t'i zhvleftësojë në mënyrë shkencore akuzat e pabaza të Goldziherit. Ai ka trajtuar në pjesën e parë

Prej tyre, në shkencat kur'anore, më i dalluari ishte Goldziheri. Ai u dha pas studimit të Kur'anit dhe shkroi vepra të shumta. Një shikim i detajuar dhe analitik na flet shumë për përmbajtjen e këtyre veprave dhe metodologjinë e tyre. Në fakt, ato pasqyrojnë në tërësi metodologjinë orientaliste në studimin dhe trajtimin e Kur'anit. Kjo metodologji shquhet për joprecizitet, shtrembërim faktesh, paqartësi rreth të kotës dhe të vërtetës, joobjektivitet, mungesë elementi shkencor etj. Madje, është interesante se studimet orientalistike fokusohen zakonisht në çështje të diskutueshme dhe pika të ndjeshme për ummetin, për të mbjellë dyshime dhe për të shkaktuar hutim në radhët e muslimanëve, për ta lehtësuar kështu edhe më shumë rrugën e largimit të tyre nga feja. Me gjithë këto sulme të pareshtura dhe këto breshëri akuzash e shpifjesh në vazhdimësi ndaj Kur'anit dhe Sunnetit⁴, Allahu i Madhëruar, me urtësinë dhe mëshirën e Tij, ka caktuar që në këtë ummet të ketë njerëz të fortë si guri, të cilët do t'i zhvleftësojnë shkencërisht akuzat e tyre dhe do ta sqarojnë të vërtetën nga e kota. Prej këtyre burrave të mëdhenj do të veçonim: Shejh Ahmed Ibn Abdul Aziz Zejjatin, Shejh Dr. Mhamud Ibn Sibevejh el-Bedewi, Shejh Mahmud Ibn Abdul Halik Xhadu, Shejh Dr. Abdul Fettah Kadiun, Shejh Ejmen Suvejdin, Shejh Abdul Hakim Ibn Abdus Selam Hatirin dhe Shejh Abdurr Rrafië Ibn Ridvanin [*Alalhu i ruajt te gjallet prej tyre dhe i pastë mëshiruar te vdekurit!*].

Në këtë punim, autori do të fokusohet vetëm në trashëgiminë e një prej këtyre personaliteteve me famë, respektivisht atë të Shejh Dr. Abdul Fettah Kadiut, për të parë kontributin e tij në studimet

të librit të tij pretendimet e Goldziherit në librin e tij 'Medhahib et-tefsir el-islamijj', për kinse dallimin e tekstit kur'anor në 16 vende dhe në 28 rreshta. Goldziheri nuk është mjaftuar me kaq, por e ka përshkruar Kur'anin si kundërthënëses dhe ka përdorur shprehje, si: '*e hasim në format e tij të ndryshme*', '*nuk është unik në pjesët e tij*', '*transmetimi i të folurit të Zotit në forma të ndryshme*', '*qarkullimi i tij në farzet (obligimet) e adhurimit në forma jo të përputhshme ndërmjet vetë*', '*lexime që dallojnë sipas stilit jo të parëndësishëm*', '*animi nga toleranca në çështjen e dallimit të leximeve - kiraeteve*', '*mbështetja në origjinalitetin e të gjitha këtyre transmetimeve të ndryshme*', e shprehje të tjera, nga inati i tij insistues dhe këmbëngulës, - siç shprehet Prof. Muhammed Haseni.

⁴ Për akuzat e Goldziherit ndaj Sunnetit shih: Dr. Sasi Salim Haxh. *Nakdu el-hitabi-l-istishrakijj - edh-dhahiretu el-istishrakijjetu ve etheruha fi-d-dirasat el-Kur'anijjeh*, f. 10-28.

kur'anore dhe demantimin e akuzave dhe shpifjeve të orientalistëve, e në mënyrë të veçantë ato të Goldziherit.

E lus Allahun për sukses!

Dr. Hajredin HOXHA

KAPITULLI I: BIOGRAFIA E SHEJH ABDUL FETTAH KADIUT

1. LETËRNJOFTIMI I SHEJHUT

1.1 Të dhëna për jetën e tij

Për jetën e shejhut kanë shkruar disa nga nxënësit dhe simpatizantët e tij, por këto materiale janë të pakta e të pamjaftueshme, kështu që është e pamundur të gjesh një biografi complete në një burim të caktuar. Kjo gjë ka diktuar nevojën e hulumtimit për detaje të jetës së tij në forume të ndryshme kur'anore në internet. Prej atyre që kanë shkruar për jetën e tij, version me të kompletuar dhe më të hollësishëm ka sjellë një nga profesorët e mi, Dr. Abdul Aziz el-Karijj, i cili, dekada më parë, shkroi për jetën e tij në revistën e Fakultetit të Kur'anit Fisnik. Po kështu, më ka rënë të lexoj edhe biografinë e tij të shkurtër të publikuar nga Universiteti Ummul Kura në Mekë, gjë për të cilën i falënderoj shumë!

1.2 Hoxhallarët e tij

Emri i tij është Abdul Fettah Ibn Abdul Gani Ibn Muhammed el-Kadi. Ka lindur më 1907, në qytetin Demenhur të Buhajres në Egjipt. Dijet e para i mori në këtë qytet, për të vazhduar më pas me mësimin e Kur'anit përmendsh, pastaj të shkencave të *texhvidit* dhe *kiraeteve* tek dijetarët e kohës në Aleksandri dhe Kajro.

Ka mësuar tek dijetarë të shumtë, si:

- 1) Ali Ijade, tek i cili mësoi Kur'anin përmendsh,

- 2) Mahmud Muhammed Gazzal dhe Mahmud Muhammed Nasruddin, nga të cilët mësoi texhvidin dhe dhjetë llojet e kiraeteve (leximeve të Kur'anit Fisnik),
- 3) Hemmam Ibn Kutb Ibn Abdul Hadi dhe Hasen Subhi, nga të cilët mësoi dhjetë kiraetet,
- 4) Mahmud Abdud Daim,
- 5) Mahmud Sheltut (Shejhu i Ez'herit),
- 6) Dr. Abdullah Draz,
- 7) Jusuf Dexhvi,
- 8) Ahmed Mekki,
- 9) Mahmud el-Hidr Husejn (Shejhu i Ez'herit), e shumë të tjerë [*Allahu i pastë mëshiruar!*].

1.3 Shkollimi

Në fillim, në Aleksandri, ndoqi Institutin e Ez'herit, ku fitoi diplomën e shkollës së mesme, për të vazhduar më pas studimet në Kajro në Universitetin e famshëm të Ez'harit dhe në vitin 1935 arriti gradën e asaj që sot njihet si doktoratë⁵.

1.4 Nxënësit e tij

Dr. Kadiu ka mësuar një numër të madh nxënësish, ndër të cilët më pas do të dalin emra të mëdhenj në fusha të ndryshme të shkencave islame, si:

- 1) Dr. Zekerijja el-Berri – ish-ministër i fesë,
- 2) Dr. Musa Shahin Lashin,
- 3) Dr. Ivedullah Hixhazi,
- 4) Dr. Ali AbduRahman el-Hudhejfi – Imami dhe hatibi i xhamisë së të Dërguarit të Allahut [*alejhis salatu ves selam*],
- 5) Shejhu Ibrahim el-Ahdar – një nga ish-imamët e xhamisë së pejgamberit,

⁵ Shih: *Mexhel-letu Kul-lijjet-i-l-Kur'ani-l-Kerim ve-d-Dirasati-l-Islamijjeti*, El-Xhamiatu-l-Islamijjetu bi-l-Medineti-l-Munevvereh, nr. 1, v.1403, Dr. Abdul Aziz el-Kari: 'El-Al-lametu esh-Shejhu Abdul Fettah el-Kadi ve etheruhu fi-d-dirasat el-kur'anijeh', f. 309-320. Shih: www.uqu.edu.sa

- 6) Shejhu Muhammed Sadik el-Kamhavi – autor i librit ‘El-Burhan fi-t-texhvid’,
- 7) Dr. Muhammed Salim Muhajsin – autor i veprave të njohura në kiraete dhe fusha të tjera,
- 8) Dr. Sha’ban Muhammed Ismail – një nga ish-profesorët e mi, i njohur për vepra të spikatura në fushën e kiraeteve dhe usuli fikhut,
- 9) Shejhu Rizk Halil Habbah,
- 10) Shejhu i njohur në botë për leximin e Kur’anit, Mahmud Halil Husari,
- 11) Dr. Abdul Aziz el-Kariij – ish-dekan i Fakultetit të Kur’anit Fisnik dhe Studimeve Islame në Universitetin Islamik të Medinës,
- 12) Shejhu Seid Ibn Ahmed Ibn Muhammed Isa es-Senedijj – një nga ish-profesorët e mi në Medinën e Ndritur dhe drejtor i shkollës fetare ‘Daru-l-Kur’an’ në Pakistan etj⁶.

2. POZITA E TIJ SHKENCORE DHE POSTET TË CILAT USHTROI

2.1 Veprat e tij

Shejh Dr. Abdul Fettah Kadiu ishte i njohur për zgjuarsinë e tij. Ai kishte një metodë dhe stil të lartë shpjegimi, kishte memorie të fortë dhe ishte i njohur për dije në fusha të ndryshme, fetare e shkencore, si: kiraete dhe shkenca kur’anore, Fikh dhe usul, tefsir dhe hadith, gjuhë dhe letërsi arabe etj.

⁶ Ibid.

Ai ishte mësues i dalluar dhe shquhej për elokuencë dhe rrjedhshmëri në të folur. Kur fliste, të folurit e tij mund ta kuptoje shumë shpejt. Prej tij dolën mijëra studentë, nga dy prej universiteteve më me famë në botë, atij të Ez’herit dhe atij të Medinës⁷.

Shejhu, siç përmend një nga ish-studentët e tij, Dr. Abdul Aziz el-Kariij, ka shkruar vepra të shumta, dikur rreth 25 sosh, shumica e të cilave kanë për temë shtjellimi Kur’anin dhe shkencat e tij. Ja veprat e tij:

Nr.	Titulli dhe përmbajtja
a. Libra autoriale	
1.	<i>El-vafi fi sherhi-sh-shatibijeh fi-l-kiraat es-sebë</i>
	Është një komentim përmbledhës i veprës <i>Lamije</i> të Imam Shatibiut, e njohur si Shatibijeh. Ka gjithsej 1173 vargje. Për rëndësinë që ka flet fakti se shumë dijetarë, si Sehavi, Xha’beriu, Ebu Shameh, Ibnul Kasih, Musuliu, Sujuti etj., e kanë komentuar atë.
2.	<i>El-idah li metni-durreh fil kiraati-th-thelath el-mutemmimeti lil kiraat el-ashr</i>
	Një komentim përmbledhës po kështu i veprës së njohur të Ibnul Xhezeriut <i>Ed-durretu-l-mudijeh</i> , e cila trajton leximet e tre imamëve Ebu Xha’fer Medeniut, Ja’kub Hadremiut dhe Halef Ibni Hisham el-Kufiut. Vepra ka 240 vargje. Vepra nuk është komentuar shumë nga dijetarët e mëparshëm, kështu që kontributi i Dr. Kadiut në këtë drejtim është shumë i rëndësishëm, ngase sjell para nesh një pjesë të trashëgimisë sonë shkencore, të panjohur hollësisht më parë. Libri ka 130 faqe të formatit të mesëm.
3.	<i>El-budur ez-zahire fil kiraat el-ashereh el-mutevatireh min tarikat esh-shatibijeh ve-d-durreh</i>
	Është një prej veprave më të mira të shejhut dhe më e dobishmja

⁷ Ibid.

	për studentët e lëmit të kiraeteve. Në këtë vepër, ai i ka mbledhur të dhjetë leximet nga veprat shatibijeh dhe durreh, si dhe i ka renditur sipas radhitjes kur'anore, duke bërë shpjegim fjalë për fjalë. Në fakt, ai nuk ishte i pari në përdorimin e kësaj metodologjie, pasi që para tij, dijetari i madh Safaksiu, kishte bërë një vepër të ngjashme, ku kishte mbledhur shtatë leximet dhe i kishte radhitur kësisoj në një vepër të njohur, titulli i së cilës ishte 'Gajthu-n-nef'i fi-l-kiraat es-seb'ë.' Libri ka 360 faqe.
4.	<i>Sherhu Minhati Mevla-l-Berr fima zadehu kitabu-n-neshri fi-l-kiraati-l-ashr ala-shatibijeh ve-durreh</i> Minhatu Mevla-l-Berr është një poemë e Shejhut Muhammed Ibn Muhammed Hilal el-Ebjari, e cila ka 140 vargje. Ajo fillon me këtë varg: قال محمد هلا لي راجيا إلهه عفوا عميما كافيا حمدا لمولانا مصليا على محمد والآل ما تال تلا وهاك ما للكل نشر زاده عما بدرة وجرز سرده Muhammed Hilali thotë duke lutur Zotin e tij për falje të përgjithshme e të mjaftueshme Falënderim Zotit tonë ndërsa salavate për Muhammedin dhe familjen sa lexuesi të lexojë Ja, tërë atë që Neshri e ka shtuar Atë çfarë në Durreh dhe Hirz gjendet, më pas e ka prurë
5.	<i>En-Nudhum el-xhami li kiraeti-l-Imami-n-Nafië</i> Imam Nafiu është imami i njohur i Medinës në kiraet në kohën e imam Malikut. Ishte i njohur në këtë fushë, madje më kompetenti në kohën e tij, aq sa kur Imam Maliku pyetej për diç nga kjo lëmi, pyetjen e adresonte tek ai duke thënë: Për çdo dije, pyeten të zotët e saj. Është lexuesi i parë në radhitjen e veprave Shatibijeh dhe Durreh. Vepra ka 294 vargje dhe fillon me këtë varg: بمحمد منشي العالمين أبتدي ثم الصلاة والسلام الأبدى على رسول الله خير الخلق ومرشد الورى لنور الحق وآله وصحبه الأعلام وقارئ القرآن بالأحكام

	Me falënderimin për Krijuesin e botëve filloj, Pastaj salate dhe selam çoj Për të Dërguarin e Allahut, krijesën më të mirë Udhëzuesin e njerëzve në dritës e së vërtetës Për familjen dhe shokët e tij të shquar Për atë që Kur'anin sipas dispozitave e ka lexuar
6.	<i>Sherhu-n-nudhumi-l-xhamië</i>
	Komentim i veprës paraprake. Është një komentim i shkurtër por i qartë. Në botimin e dytë, në Tanta të Egjiptit, ka gjithsej 194 faqe.
7.	<i>El-kiraat esh-shadh-dheh ve tevxhihuha min lugatil arab</i>
	Në këtë libër autori trajton leximet e disa imamëve: Ibn Muhajsin Muhammed Ibn AbduRrahman el-Mekki (vd. 132 h.); Jahja el-Jezidi Ebu Muhammed Jahja Ibn Mubarek el-Basriij (vd. 202 h.); A'mesh Ebu Muhammed Sulejman Ibn Mehran Kufiu (vd. 148 h.).
8.	<i>Es-sirru-l-mesun fi rivajeti Kalun min esh-Shatibijeh</i>
	Është një poezi për sqarimin e asaj që Kaluni dallon nga Versha. Është botuar në shtypshkronjën Abdul Hamid Hanefi, në Kajro.
9.	<i>Sherhu sirr-rr-i-l-mesun</i>
	Komentim i veprës paraprake.
10.	<i>El-feraid el-hisan fi uddi aji-l-Kur'an</i>
	Është një përmbledhje prej 130 vargjesh nga ajo që njihet si bahru-rrixhz⁸, me një stil të ëmbël dhe të lehtë. Vepra hapet me këtë varg: أحمد ربي وأصلي سرمدا على رسول الله مصباح الهدى وهاك خلف علماء العدد في الآي منظوما على المعتمد سميته الفرائد الحسانا أرجو به القبول والإحسانا E falënderoj Zotin tim dhe lutem përherë Për të Dërguarin e Allahut, nurin e udhëzimit Dhe ja mendimet e dijetarëve rreth numrit të ajeteve me një një forme poezie për atë që si më e pranuar

⁸ 'Bahru-rr-rixhz' është një lloj poezie, vargjet e së cilës nuk janë të plota. (shën. i përkth.)

	E kam quajtur perla të bukura Kam shpresë se do të pranohet dhe mirësi për hir të saj do të më goditet
11.	<i>Nefaisul bejan sherhu feraidil hisan</i> Është komentim i veprës paraprake. Ka 56 faqe të formatit të vogël.
12.	<i>Beshiru-l-jusri sherhu nadhimeti-z-zehri fi ilmi-l-fevasil</i> Fjala është për librin 'En-nudhum' të imam Shatibiut, që ka për tematikë numërimin e ajeteve kur'anore. Quhet edhe 'Ilmu-l-fevasil'. Në fakt, ky libër është një version i shkurtuar i librit 'El-bejan' të Ebu Amr Daniut. Ka gjithsej 297 vargje nga Bahru-t-Tavili⁹, të cilat fillojnë me këtë varg: بدأت بحمد الله ناظمة الزهر لتجني بعون الله عينا من الزهر وعذت بري من شرور قضائه ولدت به في السر والجهر من أمري بحي مرید عالم متکلم سمیع بصیر دائم قادر وتر Nadhimete Zehrin e fillova me falënderim për Allahun Që me ndihmën e Tij të na vjelë një tufë me lule Kërkova mbrojtje tek Allahu nga dëmi i asaj që ka caktuar Dhe u strehova tek Ai për çështjen time në vetmi e publik U strehova tek i Gjalli, Ai që dëshiron, Dijetari, Folësi Dëgjuesi, Parësi, i Përherëshmi, i Forti dhe i Vetmi
13.	<i>Tarihu-l-Mus'hafi-sh-sherif</i> Titulli flet edhe për përmbajtjen. Libri trajton historinë e Mus'hafit në kohën e sahabëve [Allahu qoftë i kënaqur me ta!], sikurse që flet për shkrimin, pikësimin dhe vokalizimin e tij, për kushtet që duhet t'i plotësojë shkruesi i Kur'anit, shtëpitë botuese, për renditjen e ajeteve kur'anore, kapitujt përkitazi me shkaqet e shpalljes së ajeteve. Autori përmend edhe mendime të ndryshme të dijetarëve duke i diskutuar ato, si dhe duke përvetësuar atë që, në bazë të dëshmive, del se është më i vërteti. Këtë aspekt ndoshta e gjejmë më të theksuar tek çështja e kopjeve të Kur'anit në kohën e Uthmanit [Allahu qoftë i kënaqur me të!], të

⁹ Lloj poezie në gjuhën arabe. (shën. i përkth.)

	cilat u shkruan në shtatë dialekte – lexime (ar. <i>kiraetet</i>). Libri, tash në botimin e tij të dytë, ka gjithsej 168 faqe të formatit të vogël.
14.	<i>Sherhu el-mukaddimeti el-xhezerijjeh</i>
	Libri <i>El-mukaddimetu el-xhezerijjeh</i> është shumë i njohur në Texhvid. Përdoret shumë nga ata që i qasen mësimi përmendsh të Kur'anit. Si libër i është atribuuar shejhut tonë, porse a është ende në dorëshkrim apo është botuar, këtë nuk mund ta di, pasi që nuk kam mundur ta gjej ndonjë kopje të tij.
15.	<i>Min ulumi-l-Kur'an</i>
	Është një libërth tërheqës, në të cilin autori trajton disa çështje që kanë të bëjnë me Kur'anin, si: domethënia e Kur'anit, emrat e tij, ajetet mekase dhe medinase, shkrimi dhe kodifikimi i tij, radhitja, ajetet e qarta dhe të paqarta, shembujt kur'anorë, betimet e tij, ajetet që sipërfaqësisht duken kundërthënëse, metodat, tregimet etj. Libërthi shquhet për metodën e tij tërheqëse, të qartë dhe të kuptueshme. Është ndër më të mirët e këtij lloji, veçanërisht për fillestarët.
16.	<i>Tarihu-l-Kurr-rra'i-l-ashr ve ruvatihim ve tevaturu kiraatihim ve menhexhu kul-lin fi-l-kiraeh</i>
	Është libër i formatit të mesëm dhe ka gjithsej 46 faqe.
17.	<i>Ebath fi kiraat el-Kur'ani-l-Kerim</i>
	Në këtë libër autori trajton 13 çështje të rëndësishme, që kanë të bëjnë me leximet – kiraetet, të cilat, siç i ka numëruar vetë ai në parathënie, janë: 1) Hadithet që flasin për shpalljen e Kur'anit në shtatë germa ¹⁰

¹⁰ Për të vërtetën, përkitazi me shtatë gerrat dhe karakteristikat e tyre, Dr. Rexhep Abdul Murdijj Amir, thotë:

- Shtatë germa(leximet e Kur'anit) janë ngjarje me dëshmi të vërteta, që portretizojnë një shumëllojshmëri në shprehjet e leximit kur'anor, të cilin Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ua lexoi sahabëve [*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*]
- Shumëllojshmëria e tyre nuk është për shkak të kundërthënies por vetëm për shkak të ndryshimit.
- Ato kanë ngjyrë fetare, pasi që i atribuohen Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*] dhe miratimeve të tij.

	2) Çka nënkuptojnë shtatë germat? 3) Urtësia e shpalljes së Kur'anit në shtatë germa 4) Çfarë mund të përfitohet nga hadithet e transmetuara me këtë tematikë? 5) Leximet e shtatë imamëve dhe lidhjet e tyre me shtatë germat 6) Leximet e dhjetë imamëve si pjesë e shtatë germave 7) Tevaturi (saktësia maksimale) e leximeve të dhjetë imamëve 8) Kriteri i leximit mutevatir (të saktë) 9) Ndarja e leximit autentik 10) Dispozita e mohimit të leximit të vërtetuar sipas tevaturit 11) Shkaku pse leximet i atribuohen sahabiut ose lexuesit 12) Leximet janë alternativa të lexuesve – sqarimi përkatës 13) Mendimi ynë. Ky libër, megjithëse është i vogël, është përplot dituri. Ai në fakt përfaqëson mendimin e shejhut për çështjet në fjalë, të cilat, siç e dimë, janë të diskutueshme tek dijetarët. Mendimi ose opinionin e shejhut është se këto janë çështje alternative dhe se nuk kanë karakter obligues, veçse për autorët apo koleksionuesit e tyre. Libri, që është botuar në Kajro nga AbduRrahman Muhammedi, ka gjithsej 31 faqe të formatit të mesëm.
18.	<i>El-kiraat fi nadhri el-musteshrikine vel mulhidine</i>

- Nuk kërkohet detyrimisht qëllimi i saktë i ndonjëres prej tyre, pasi që po të ishte kështu, Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] nuk do e linte pa e sqaruar këtë gjë.
- Domosdoshmëria e marrjes (pranimit) të tyre gojarisht, ndryshe nuk pranohen sipas peshojave (mënyrave) të tjera.
- Emërtimi i tyre 'lexime' dhe përcaktimi i tyre në 'shtatë' është gjë e lejuar, pasi që një gjë e tillë është vërtetuar në hadith. Kjo sa i përket shprehjeve dhe jo kuptimeve.
- Ato janë si lehtësim hyjnor për ummetin për ta lexuar Kur'anin.
- Ndalohet polemizimi për shkronjat e tij të vërtetuara apo mohimi i tyre, ngase kjo do të ishte madje edhe kufër (dalje prej fesë).

Ka komentime të shumta përkitazi me atë se çka në të vërtetë synohet me 'shtatë germat': gjuhë, dialekt, lexim, apo edhe mendime të tjera, të cilat janë brenda suazave të Kur'anit dhe Sunnetit. Çdo ixhtihad (përpyetje shkencore) ka pranimin dhe vlerësimin e saj. Shih: *Err-rru'jetu el-istishrakijjetu li-l-ahrufi-s-sebati ve-l-kiraati-l-kur'anijjeh – ard ve nakdun*. Konferenca për Kur'anin Fisnik në Studimet Orientalistike, 16-17/10/1428 h., Medinë, f. 9-10.

	Ky është një ndër librat më të mirë të punuar nga shejhu. Në të, shejhu demanton një nga një akuzat e Goldziherit, i cili, në mënyrë të qëllimshme, tenton të njollosë kiraetet, e me këtë t'ia ulë vlerën Kur'anit. Gjatë diskutimit të shpifjeve dhe akuzave të pabaza të Goldziherit, mund të vërehet lehtë dituria e thellë që ka Dr. Abdul Fettah Kadiu. Ai sjell shembuj të shumtë për të dëshmuar pavërtetësinë e asaj që pretendon Goldziheri dhe të ngjashmit me të. Libri, në botimin e dytë nga shtëpia botuese ed-Dar në Medinën e Ndritur, ka gjithsej 203 faqe të formatit të vogël. Njëherësh, ky është libri tek i cili do ta fokusojmë studimin tonë.
19.	<i>Esbab en-nuzul ani-s-sahabeti ve-l-mufessirine</i> Është libër i formatit të madh. Konsiderohet si më i miri i llojit të vet. Shejhu i ka vënë vetes obligim që të mos sjellë në këtë libër asnjë transmetim përveçse që të jetë i saktë, në përputhje me kuptimin dhe synimet e ajeteve, në harmoni me synimet e përgjithshme të besimit islam, në një vijë me rregullat dhe kriteret e vëna nga dijetarët etj. Shejhu ndonëse sjell edhe burimet e transmetimeve, megjithëkëtë nuk bën ndonjë studim kritik të tyre. Libri ka gjithsej 256 faqe.
20.	<i>Urxhuzetul mirath</i> Poezi që trajton shkencën e Feraidit, shkencën që ka të bëjë me ndarjen e trashëgimisë. Ka 158 vargje dhe hyn në tipin e poezive të Bahru-rr-rixhazit. Është hapur me këtë poezi: الحمد لله القديم الباقي مقدر الآجال والأرزاق ثم الصلاة والسلام أبدا على النبي العربي محتدا وهذه أرجوزة الميراث نظمتها للفتية الأحداث Falënderimi i takon Allahut, të Parit të Gjithmonshëm Përcaktuesit të exheleve (afateve) dhe furnizimeve Pastaj, bekimet dhe përsëndetjet qofshin për përherë Për pejgamberin arab, pandërprerë
21.	<i>Sherhu erxhuzetil mirath</i> Është komentim i veprës paraprake, me të cilin autori ka synuar

	t'ua lehtësojë fillestarëve këtë shkencë. Megjithëkëtë, autori nuk i ka përshtirë të gjithë kapitujt e kësaj shkence, madje ata më kompleksët i ka braktisur fare. Libri është botuar në Kajro dhe ka 139 faqe të formatit të vogël.
22.	<i>Es-sijamu fedailuhu ve ahkamuhu</i>
	Është një libër që flet për agjërimin, por që shquhet për një metodë shumë tërheqëse. Autori përmend mendimet e dijetarëve dhe argumentet e tyre. Për herë të parë është botuar nga Akademia e Hulumtimeve Islame në Az'har, në vitin 1392 h. Ka 175 faqe të formatit të vogël.
b. Libra të recensuar	
1. (23)	<i>Tahbiru-t-tejsir fi kiraat el-eimmeti-l-ashr</i>
	E ka recensuar dhe ka dhënë shënime me vlerë, në bashkëpunim me Shejh Muhammed Sadik Kamhavin, që njëherësh është dhe student i tij. Është botuar nga Darul va'ji, në Halep, në vitin 1393 h. Ka 206 faqe.
2. (24)	<i>Sherhu telhisil feva'id ve takribu el-mutebaidi ala ukajleti etrabil kasaid</i>
	Fjala është për librin e famshëm të Shatibiut në lidhje me shkrimin e Mus'hafit. Ka 298 poezi. I përket llojit të poezive <i>Bahru-l-besit</i> . Fillon me këtë varg: الحمد لله موصولا كما أمر مباركاً طيباً يستنزل الدررا Falënderimi, pandarë, ashtu edhe siç ka urdhëruar, i takon Allahut të bekuar, të mirë, i Cili sjell furnizimin
3. (25)	<i>Delilul hajran shehu mevriddi-dh-dham'an</i>
	Fjala është për poezinë 'Meuridu-dh-dham'an fi ilmi resmi-l-Kur'an', e cila ka 454 vargje, të tipit Bahru-r-rrixhz. Vargjet janë përpiluar nga Ebu Abdullah Muhammed Ibn Muhammed Ibn Ibrahim el-Emevijj esh-Sherishijj, i njohur me emrin Harraz. Ndërsa ai që i komentoi këto poezi është dijetari Ibrahim Ibn Ahme del-Margani nga Tunizia. Shejh Abdul Fettah Kadiu e ka recensuar këtë libër dhe ka dhënë shënime me vlerë për të. Libri ka 479 faqe dhe është botuar në Kajro,

	nga Daru-l-Kur'an ¹¹ .
Vërejtje: Shumica e librave të tij janë pjesë e materialeve universitare në Az'har dhe në universitete të tjera islame. Veprat e tij janë pranuar nga të gjitha shtresat. E lusim Allahun ta ketë shpërblyer për to!	

2.2. Pozitat dhe funksionet që ushtroi

- Menjëherë pas diplomimit, u emërua mësues në institutin e mesëm të Az'harit në Kajro.
- U emërua shejh (hoxhë) i leximeve të Kur'anit në Departamentin e Kiraeteve në Fakultetin e Gjuhës Arabe në Az'har.
- Kontrollor i përgjithshëm në institutet ez'heriste.
- U emërua shejh nga Az'hari në Institutin e Az'harit në Desuk dhe Demenhur.
- U emërua agjent i përgjithshëm i instituteve të Az'harit dhe, më pas, edhe drejtor i përgjithshëm, funksion ky në të cilin mbeti deri në pensionim.
- Që nga themelimi i Akademisë për Hulumtime Islame, në vitin 1950, ishte angazhuar në të, një herë si anëtar, ndërsa nga viti 1957 e deri në vdekje si udhëheqës i saj.
- Ishte anëtar e më pas edhe Kryetar i Këshillit të Testimit të Lexuesve të Kur'anit, pranë Radios së Republikës së Egjiptit.
- Me kërkesë të ish-myftiut të Arabisë Saudite, Shejh Abdul Aziz Ibn Bazit, do të transferohet në Medinën e Ndritur për të dhënë mësim atje. Do të mbetet në krye të Departamentit për Lexime në Fakultetin e Kur'anit Fisnik dhe Studimeve Islame deri në

¹¹ Shih: Mexhel-letu Kul-lijjeti-l-Kur'ani-l-Kerim ve-d-Dirasati-l-Islamijjeti, El-Xhamiatu-l-Islamijjetu bi-l-Medineti-l-Munevvereh, nr. 1, v.1403, Dr. Abdul Aziz el-Kari: 'El-Al-lametu esh-Shejhu Abdul Fettah el-Kadi ve etheruhu fi-d-dirasat el-kur'anijeh', f. 309-320. Shih: www.uqu.edu.sa

vdekje. Kështu është puna e dijetarëve ndërmjet vete, e vlerën e të vlerësuarve nuk e di kush pos të vlerësuarve!

2.3. Sinqeriteti i tij në mësimdhënie dhe sekretet e suksesit të tij

Shejh Abdul Fettahu ka mbetur për të mirë në kujtesën e kolegëve të tij. Ai përmendet për zgjuarsinë, të kuptuarit dhe ndikimin e madh që kishte. Një profesor im i nderuar, Dr. Abdul Aziz el-Kari ka thënë: Të gjithë ata që vijonin mësimet tek ai, ishin të lidhur shumë me të. Kur i pyeta për këtë, më thanë se një çështje që të tjerët e shpjegonin për ditë të tëra, ai e shpjegonte vetëm për pak minuta, duke e bërë atë të qartë si dielli (që shihet gjatë ditës). Këtë e komentova, së pari, si sinqeritet të tij, ngase sinqeriteti bën çudira dhe, së dyti, si pjekuri profesionale, ngase ai e ka kaluar jetën e tij duke bredhur nëpër shtigjet e këtyre shkencave.

Ai kishte një intuitë të atillë që thuajse nuk gabonte kurrë. Një vëlla musliman, që më ka lutur ta mbaj anonim, më ka treguar për rastin e shejhut me një student, të cilin sa herë që e takonte, i thoshte: -A ende je në sipërfaqen e saj? Dikur, studenti sikur u lodh nga këto fjalë dhe u hidhërua e u mllëfos, ngase kujtoi ajetin:

E sikur All-llahu t'i kapte njerëzit sipas veprave (të këqija) të tyre, nuk do të linte mbi faqen e dheut asnjë gjallesë, por Ai i afatizon deri në momentin e caktuar, e kur të vijë afati i tyre, s'ka dyshim se All-llahu i ka parasysh robërit e vet.” (Fatir, 45)

Më vonë, u binda për fjalët e shejhut – vazhdon rrëfimin ky vëllai im, – ngase studenti në fjalë erdhi dhe më kërkoi leje për ta braktisur Medinën dhe për t’u transferuar në Rijad. E tërë kjo ndodhi vetëm pak muaj para se ai student të diplomonte.

Një herë tjetër, njëri nga studentët e tij lexonte ajetin kur’anor:

Dhe atë ditë sillet xhehenemi, e atëherë njeriut i bie në mend, e prej nga atij përkujtimi?” (el-Fexhr, 23)

Shejhu i kishte thënë: -O filan, si thua të ndalesh tek ‘Xhehenemi’ (“*Dhe atë ditë sillet xhehennemi...*”)? Pas mbarimit të ligjëratës, njëri nga të pranishmit më tha: -Kurrë nuk do ta harroj këtë ndalje (që bëri në këtë ajet)!

Shejhu ishte shumë i afërt me studentët. Ai kishte një metodë sjelljeje brilante. I mbante lidhjet me studentët, pyeste për ta dhe u kërkonte që ta vizitonin edhe në shtëpi. Të gjithë e donin dhe e nderonin si prind.

Kështu duhet të jetë ligjëruesi, ngase disa ligjërues, për fat të keq, janë të ngurtë, të vrazhdë, nuk takohen me studentët përveçse gjatë kohës së ligjëratave, gjë kjo që nuk i shkon për shtat profesionit të tyre, që njëherësh është edhe edukativ. Kështu ka qenë puna e të parëve tanë, që përveç dijes jepnin dhe edukatë¹².

Kemi shumë nevojë që këtë etikë ta përvetësojmë në praktikën tonë. Jam ndier si mos më keq kur pashë një profesor tek i thoshte studentëve se e tëra që kanë ndërmjet vete kufizohet brenda objekteve universitare dhe orës së mësimi, ndryshe nuk njihen dhe nuk ka as përsëritje dhe as konsultime. Profesorë si ky janë shkaktarë të sjelljeve të çoroditura të nxënësve dhe studentëve. Le të mbetet shëmbëlltyra e shejhut model për ne, për formën se si duhen trajtuar studentët!

3. VDEKJA E TIJ

¹² Shih: *Mexhel-letu Kul-lijjeti-l-Kur’ani-l-Kerim ve-d-Dirasati-l-Islamijjeti*, El-Xhamiatu-l-Islamijjetu bi-l-Medineti-l-Munevvereh, nr. 1, v.1403, Dr. Abdul Aziz el-Kari: ‘El-Al-lametu esh-Shejhu Abdul Fettah el-Kadi ve etheruhu fi-d-dirasat el-kur’anijeh’, f. 309-320. Shih: www.uqu.edu.sa

Pas një sëmundjeje, që e kishte goditur në Medinën e Ndritur, shejhu u kthye në Egjipt, ndërsa më 01.11.1982 vdes dhe varroset në Kajro.

Allahu e pastë mëshiruar, ndërsa për kontributin e tij të madh e shpërbleftë me xhenet!

II. KONTRIBUTI AKADEMIK I SHEJH ABDUL FETTAH EL-KADIUT NË FUSHËN E MBROJTJES SË LEXIMEVE DHE STUDIMEVE KUR'ANORE

Kontributi i Shejh Abdul Fettah Kadiut në fushën e studimeve kur'anore fokusohet në tri shtylla kryesore:

- 1) Mësimdhënie,
- 2) Shkrime dhe punime
- 3) Projekte dhe themelim shoqatash për studime kur'anore.

Më së miri për këtë na flet një nga nxënësit e tij, Dr. Abdul Aziz el-Kari, i cili e kishte shoqëruar për një kohë të gjatë, edhe si koleg në universitet, por edhe si aktivist në fushën e studimeve kur'anore, i cili thotë:

“Ai kishte rolin kryesor në këtë fushë (të studimeve kur'anore). Ka dhënë një kontribut të vyer për më shumë se një çerek shekulli, kontribut ky i përqendruar në tri aspekte:

1. Mësimdhënie, në formën klasike dhe bashkëkohore

Ai e kishte bërë këtë punë për një kohë të gjatë, duke nxjerrë gjenerata të tëra studiuesish e emrash të mëdhenj në këtë fushë studimesh. Prej atyre që patën fatin të mësonin prej tyre isha dhe unë, autori i këtij punimi. Kam lexuar para tij disa pjesë kur'anore sipas versionit të Hafsës, kam lexuar dy pjesë të Shatibijes, kam lexuar dy xhuza kur'anore sipas Nafiut, pastaj edhe sipas leximit të Ibni Kethirit, por nuk e kam plotësuar.

Prej emrave më të njohur të studentëve të tij janë:

- 1) Shejh Ali AbduRrahman el-Hudhejfi – Imam në xhaminë e të Dërguari të Allahut [*alejhis salatu ves selam*]
- 2) Shejh Munir Ibn Muhammed el-Mudhaffer et-Tunisi,
- 3) Shejh Ibrahim el-Ahdar
- 4) Dr. Musa Shahin Lashin
- 5) Dr. Ivedullah Hixhazi
- 6) Dr. Zekerija el-Berr-ri etj.

2. Angazhimi në projektet kur'anore, që konsiderohet si një ndër sukseset kur'anore me ndikimin më të madh në kohën tonë

Ja disa prej imazheve të këtij kontributi:

1) Instituti i Kiraeteve në Kajro

Ky institut u themelua në vitin 1945. Në fillim ishte si aneks i Fakultetit të Gjuhës Arabe në Az'har. Studimet zgjasnin tetë vite: një vit quhej 'Ixzazetu-t-texhvid', tri vitet vijuese quheshin 'Alijetu-l-kiraaat', ndërsa ishin ekuivalente të shkollës së mesme, ndërsa katër vitet e mbetura quheshin 'Tehassus el-kiraaat' ose specializimi i leximeve.

Krahas shejhut tonë, mësim në këtë institut ka dhënë dhe një grup dijetarësh të shquar në këtë fushë, si:

- Shejh Amir Ibn Sejjid Uthmani
- Shejh Abdul Aziz Zejjat
- Shejh Ibrahim Ibn Alijj Shehateh es-Semnudi etj.

2) Kontrollimi i mus'hafëve në Egjipt

Këtë detyrë e kryente një Këshill i nxjerrë nga Akademia e Hulumtimeve Islame në Az'har, pjesë e të cilit ishin emrat më të njohur të këtij lëmi. Shejhu ynë i priu këtij këshilli deri në vdekje. Prej punës së tyre ishte nxjerrja e Mus'hafit të Az'harit, që u botua nga shtëpia botuese Daru-l-kutub el-misrijeh. Këshilli

kishte bërë disa përmirësime teknike, të cilat fatkeqësisht, më vonë, nuk i gjeje në botimet e tjera të mus'hafëve. Në disa mus'hafë të botuar më vonë mund t'i vëreje lëshimet teknike, të cilat ishin përmirësuar më parë nga Këshilli dhe unë personalisht hamendesha kur hasja në këta mus'hafë, në të cilët madje figuronte edhe emri i shejhut. Ia pata dërguar disa të tillë, por ai refuzoi të ishin bërë nga Këshilli në fjalë. Botuesit e kanë vjedhur firmën e tij dhe të Këshillit dhe i kanë vënë në këto mus'hafë, ndërsa ai dhe Këshilli nuk kanë asgjë të përbashkët me këto botime.

3) Fakulteti i Kur'anit Fisnik në Medinën e Ndritur

Ideja e themelimit të këtij fakulteti ishte tejet e qëlluar. Njerëzit për një kohë të gjatë i ishin larguar studimeve dhe arteve kur'anore, e në veçanti shkencës së kirateve, resmit (shkrimit), vokalizimit, ndarjeve etj. Ishte e vështirë të gjeje një ekspert të zotin në këtë drejtim. Frika nga mundësia e shtrembërimit të Kur'anit ishte si ajo në kohën e sahabëve, kur u vranë shumë hafëzë në beteja të ndryshme. Sigurisht, këto raste kanë dallime të mëdha, pasi që, në rastin e sahabëve, frika ishte për shkak të vdekjes së tyre në vijën e parë të frontit, ndërsa këtu frika ishte si pasojë e injorancës në raport me Kur'anin dhe shkencat e tij.

Për t'i nxitur të rinjtë për t'iu qasur studimeve kur'anore kemi parë të jenë ndërmarrë tre hapa shume seriozë:

- Shkollat e nxënies së Kur'anit përmendsh, pavarësisht se kanë qenë shkolla private apo shtetërore.
- Themelimi i mejtepeve kur'anore nëpër të gjitha xhamitë, ide kjo e rahmetliut Shejh Jusuf Sitit nga Pakistani. Praktikisht, është dëshmuar si e suksesshme, qoftë edhe për shkak të përballjes së kostos, pasi që ishin si anekse të

xhamive dhe mundësonin pjesëmarrjen e të gjitha grupmoshave dhe gjinive.

- Themelimi i Fakultetit të Kur'anit Fisnik në Medine Munvvere, për të cilin edhe po flasim. Ishte organi i parë arsimor specializues për këtë fushë dijesh në nivel universitar, andaj si i tillë vlerësohet të ketë qenë shumë frytdhënës. Nëse do një fakt të thjeshtë për t'u bindur, atëherë shih se si ishte perceptuar gabimisht që studimet kur'anore të ishin aneks i Fakultetit të Gjuhës Arabe, edhe pse duhet të ishte e kundërta. Rektori i atëhershëm i Universitetit, Shejh Abdul Aziz Ibn Abdullah Ibn Bazi, e kishte pëlqyer këtë ide dhe kishte shprehur gatishmërinë për ta themeluar këtë fakultet dhe për të dhënë çdo gjë që ishte brenda mundësive të tij për realizimin konkret të kësaj ideje. Fillimisht, Fakulteti kishte startuar me njëzet (20) studentë, të cilët paraprakisht e dinin Kur'anin përmendsh dhe e zotëronin shkencën e Texhvidit. Prej këtyre studentëve, vetëm pesë ishin saudianë, ndërsa, si gjeneratë, ata patën fatin të jenë plot katër vite me shejhun e nderuar.

Me përkrahjen e parezervuar të Shejh Ibn Bazit, shejhu kishte vënë planprogramet e këtij Fakulteti, në përpilimin e të cilave morëm pjesë ne dhe të tjerë. Shejhu, me kërkesë të Universitetit, kishte zgjedhur një grup ulemash nga Egjipti, të cilët morën përsipër mësimdhënien në këtë Fakultet.

3. Shkrimet

Kontributi më i çmuar i shejhut është në lëmin e avancimit të studimeve kur'anore. Të parët tanë kanë shkruar punime të shumta dhe me vlerë të madhe për Kur'anin, madje është fakt se nuk është

shkruar në botë për ndonjë libër qiellor më shumë se sa për Kur'anin, vetëm se disa ose shumica nga këto punime ende nuk e kanë parë dritën e botimit. Për këtë shkak, kjo fushë ka nevojë për potenciale dhe kapacitete të reja intelektuale, që t'i nxjerrin në dritë botimet e këtyre dorëshkrimeve të shtrenjta. Shejhu ynë ka dhënë kontribut të madh në këtë drejtim, duke publikuar mbi njëzet vepra kapitale për Kur'anin dhe shkencat e tij, dhe vepra të tjera në shkenca të tjera, si në Fikh dhe Feraid¹³.

¹³ Shih: *Mexhel-letu Kul-lijjet-i-l-Kur'ani-l-Kerim ve-d-Dirasati-l-Islamijeti*, El-Xhamiatu-l-Islamijetu bi-l-Medineti-l-Munevvereh, nr. 1, v.1403, Dr. Abdul Aziz el-Kari: 'El-Al-lametu esh-Shejhu Abdul Fettah el-Kadi ve etheruhu fi-d-dirasat el-kur'anijeh', f. 309-320. Shih: www.uqu.edu.sa; Shih po kështu: www.maroc-quran.com/vb/t4252.html; www.ahlalalm.org/vb/showthread.php?p=164354; www.mazameer.com/vb/t9868.html;

III. AKUZAT E GOLDZIHHERIT NDAJ LEXIMEVE KUR'ANORE DHE ZHVLEFTËSIMI I TYRE NGA ANA E SHEJH ABDUL FETTAH KADIUT

Në këtë pjesë do të trajtojmë disa dyshime shkencore dhe historike të hedhura nga lideri evropian i islamistikës, orientalisti çifut Goldziher, në librin e tij 'Medhahib et-tefsir el-islamijj', si dhe zhvleftësimin e tyre nga ana e shejh Abdul Fettah Kadiut. Sigurisht, për shkak të natyrës së punimit, nuk do të ndalemi në të gjitha dyshimet e tij. Do të fokusohemi vetëm në disa prej tyre, të cilat reflektojnë personalitetin e tij prej një mashtruesi, sharlatani dhe një njeriu që fshihte thellë në zemër çifutizmin e tij¹⁴. Vërtet, është turp për një personalitet të tillë, që pas gjithë atyre viteve kushtuar studimit të gjuhës arabe dhe Islamit, të luajë me të vërtetat, t'i shtrembërojë ato dhe të refuzojë të nënshtrohet ndaj të vërtetave kur'anore¹⁵. Ka qenë dashur, së paku, të mos merrte këtë pozicionim, pra të mos hidhte dyshime e të mos përpiquej dhe orvatej t'i largonte njerëzit nga rruga e drejtë, por e këtillë është metodologjia e Ithtarëve të Librit, çifutëve dhe të krishterëve, të cilët e pështjellin të vërtetën me të kotën.

¹⁴ Për më shumë rreth rolit çifut në studimet orientale, shih: Dr. Mahmud Hamdi Zakzuk. *El-istishrak ve-l-halfijjetu-l-fikrijjetu li-s-sirai-l-hadarij*. Kitabu-l-ummeh, 1404.

¹⁵ Se Goldziheri nuk gabon rastësisht, mësojmë edhe nga kolosi i letrave islame, Dr. Mustafa Sibai, i cili në një takim personal me një nga mësuesit e Goldziherit, orientalistin tjetër Xhozef Shaht, zbulon me shembuj se si Goldziheri kishte gabuar për gjëra që në fillim Shahti i kishte mohuar, por që më vonë ishte dorëzuar se janë të vërteta. Për më shumë detaje rreth kësaj shih: Vezan, Adnan Muhammed. *El-istishrak ve-l-musteshrikune -vixhhetu nadhrin*, botim i Ligës Islame, nr. 24, 1404, f. 96-97.

1. DYSHIMI I PARË DHE DEMANTIMI I TIJ

Në librin e tij të sipërpërmendur, Goldziheri thotë:

“Nuk ka ndonjë libër legjislativ, - të pranuar si pjesë besimi nga ndonjë grup fetar se është tekst i zbritur apo i shpallur (nga qielli), - i cili e ofron tekstin e vet në fazën më të hershme të tij me këtë formë çrregullimi dhe jostabiliteti, siç është teksti kur'anor...”

Demantimi i Shejh Abdul Fettah Kadiut ishte siç vijon:

Është e pamundur që tekstin kur'anor ta përshkojë çrregullimi¹⁶, apo që ai të shoqërohet me frikë dhe stres, ngase domethënia e çrregullimit dhe jostabilitetit në tekstin kur'anor nënkupton që teksti të lexohet në disa forma dhe ndërmjet tyre të ketë mospërputhje në kuptime dhe qëllime. Kjo, sigurisht, se nuk mund të ndodhë në Kur'an. Transmetimet e ndryshme dhe aspektet e shumëllojshme¹⁷ që janë përcjellë për tekstin kur'anor nuk kanë kundërthënie, as në domethënie dhe as në qëllime. Nëse analizojmë hollësisht kiraetet, ato të tipit mutevatir, meshhur dhe sahih, do të vërenim se mospërputhja qëndron në njërën nga këto dy lloje:

- 1) Dallimi i kiraeteve në tekst (shprehje) por jo edhe në qëllim. Ky lloj i referohet dallimeve të gjuhëve, si p.sh., leximi i fjalës 'Sirat' në ajetin e gjashtë në kaptinën el-Fatiha:

Udhëzона (përforcona) në rrugën e drejtë!”

...me 's' të fortë (sad- ص) dhe me 's' të butë (sin- س).

Apo, edhe leximi i fjalës 'el-Bukhl' në ajetin 24 nga kaptina el-Hadid:

¹⁶ Shih: el-Kattan, Mennaë. *Nuzulu-l-Kur'ani ala seb'ati ahrufin*, f. 30-50.

¹⁷ Për më shumë rreth kësaj shih: Muhajsin, Muhammed Salim. *El-muhedh-dheb fi-l-kiraat el-ashr ve tevoxhihuha*. Mektebetu kul-lijjati-l-ez'herijeh, 1978.

﴿الَّذِينَ يَبْخُلُونَ وَيَأْمُرُونَ النَّاسَ بِالْبُخْلِ وَمَنْ يَتَوَلَّ فَإِنَّ اللَّهَ هُوَ الْغَنِيُّ الْحَمِيدُ﴾ [الحديد: ٢٤]

Të cilët vetë bëjnë koprraci dhe me koprraci i këshillojnë njerëzit. E kush largohet prej dhënies, le ta dijë se All-llahu është i begatshëm, i lavdishëm.”

...duke vokalizuar shkronjën ‘b’ me zanoren ‘u’ ndërsa ‘h’-në pa zanore fare (me sukun), pra ‘buhl’, apo duke i vokalizuar që të dyja me zanoren ‘e’.

Ngjashëm është edhe puna me leximin e foljes ‘Jahsebu’ në ajetin e tretë të kaptinës el-Humeze:

E mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm.”

....respektivisht, leximin e shkronjës ‘s’ duke e vokalizuar me zanoret ‘e’ ose ‘i’.

Urtësia e shpalljes së Kur’anit edhe me këtë lloj është që njerëzve me gjuhë të ndryshme t’iu lehtësohet leximi¹⁸. Prej këtij lloji ka edhe pjesë që nuk janë si rezultat i dallimeve gjuhësore por janë vetëm pjesë të të folurit letrar, si p.sh.:

Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili).“ (esh-Shuara, 193)¹⁹

Folja ‘nezele’ është lexuar me dyfishimin e shkronjës ‘z’ (nezzele) dhe pa dyfishimin e saj, sikurse që emri ‘ruh’, gjegjësisht shkronja e fundit

¹⁸ Rreth urtësisë së shpalljes së Kur’anit me shtatë germa ka folur edhe Ibnul Xhezriji, i cili ka thënë: ‘Arabët, në gjuhën e të cilëve u shpall Kur’ani, kishin gjuhë (dialekte) të shumta dhe të ndryshme dhe e kishin të vështirë të kalonin nga një dialekt në tjetrin, madje në raste të caktuara një gjë e tillë nuk do të mund të bëhej as me trajnim dhe ushtrim, sidomos për pleqtë dhe gratë...Kësisoj, shpallja e Kur’anit vetëm me një germë do të ishte diç e rëndë për ta, që nuk mund të përballohej...’ Shih: En-neshru fi-l-kiraat el-ashr, 1/22. Për këtë gjë shih edhe një punim të rëndësishëm të Dr. Abduhu Raxhihit: El-lehexhat el-arabijeh fi-l-kiraat el-kur’anijeh. Mektebetu-l-mearif, Rijad, 1999.

¹⁹ Kadi, Abdul Fettah. El-kiraat fi nadhri el-musteshrikine, f. 20-23.

e saj, 'h' -ja, është lexuar me zanoren 'u' (err-rruhu) dhe me 'e' (err-rruhe).

Pastaj, shejhu sqaron se, si formë, është evidente edhe në traditën e arabëve, madje, përderisa domethënia e fjalës mbetet e pandryshueshme, nuk ka gjë të keqe në këtë përdorim²⁰.

2) Lloji i dytë është kur leximet dallojnë në shprehje dhe domethënie, por që të dy domethëniet mbasin të shëndosha dhe të pranuar; pra, as nuk përputhen dhe as nuk kundërshtohen. Këtë mund ta hasim në ajetin 259 të kaptinës el-Bekare, gjegjësisht në pjesën:

...shiko se si i kombinojmë eshtrat e pastaj i veshim me mish..."

Folja 'nunshizuha' نُنْشِرُهَا është lexuar me shkronjën 'z', që ka kuptimin e kombinimit, por është lexuar edhe me shkronjën 'r' (nunshiruha), نُنْشِرُهَا që ka kuptimin e ringjalljes pas vdekjes për të dhënë llogari²¹. Kuptimet - vazhdon të sqarojë shejhu - janë të ndryshme, por ato nuk bien ndesh me njëra-tjetrën, përkundrazi, ngase Allahu kur t'i ringjallë krijesat, urdhëron bashkimin e eshtrave e pastaj i ringjall për llogari²².

Kështu qëndron puna edhe me një pjesë të ajetit 18 nga kaptina el-Hadid:

²⁰ Dijetarët kanë sqaruar se me pranimin e Islamit nga fise të ndryshme, ata sollën edhe dialektet e tyre të ndryshme. Në mesin e tyre kishte fëmijë që ende gabonin në gjuhë, kishte shërbëtorë injorantë, kishte gra dhe pleq të shtyrë në moshë, të cilët Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] i pranoi për t'iu bashkëngjitur kësaj feje. Madje ata kanë përmendur edhe hadithin: 'Jam dërguar tek një popull që nuk di shkrim-lexim dhe në mesin e tyre ka fëmijë, shërbëtorë, pleq..'. Shih: Tefsir et-Taberijj, 1/35; El-burhan fi ulumi-l-Kur'an të Zerkeshiut, 1/227.

²¹ Ibid, f. 24. Shih edhe: El-Xhezriij, *En-neshru fi-l-kiraat el-ashr*, 1/50.

²² Kadi, Abdul Fettah, *El-kiraat fi nadhri el-musteshrikine*, f. 30.

S'ka dyshim se ata që japin lëmoshë (sadaka) dhe që singërisht japin për hir të All-llahut..."

Këto dy fjalë, gjegjësisht shkronja 's' në to, është lexuar me dyfishim dhe pa të. Në rastin e parë, ajo nënkupton ata që japin pjesë të pasurisë së tyre, qoftë kjo e obliguar (zekati), apo edhe vullnetare, siç është lëmosha. Ndërsa në rastin tjetër, pra kur të lexohet pa dyfishim, ato nënkuptojnë besimtarët që i përkushtohen fesë, që i nënshtrohen asaj dhe dispozitave të saj. Pra, janë dy domethënie të ndryshme, por që bashkohen në karakterin dhe personalitetin e besimtarit lëmoshëdhënës²³. Urtësia e këtij lloji, shton shejhu, është që ajeti të luajë rolin e dy ajeteve që kanë ardhur për dy domethënie bashkë²⁴.

Këto janë dy lloje të dallimeve në kiraete, ndërsa sa i përket asaj se ka dallime në shprehje dhe domethënie, dhe këtë me pamundësi përputhjeje ndërmjet tyre, kjo është e pamundur në Kur'an. Allahu i Madhëruar ka thënë:

A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej All-llahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie." (en-Nisa, 82)

Për të vërtetuar se nuk ka kundërthënie në kiraetet e Kur'anit, shejhu citon edhe Ibni Kutejben, i cili në librin e tij të famshëm 'Mushkilul Kur'an' thotë: "Dallimi është dy lloje: dallim i ndryshimit dhe dallim i mospërputhjes. Sa i përket këtij të fundit, ai, falënderuar qoftë Allahu, nuk gjendet në Librin e Tij, ndërsa i pari është i lejuar..." Pastaj ai sjell shembuj kur'anorë duke argumentuar se lloji i parë lejohet dhe se

²³ Shih: Kadi, Abdul Fettah. *El-budur ez-zahireh fi-l-kiraat el-ashr el-mutevatire min tarikat esh-shatibijeh ve-d-durr-rreh*, f. 50-55.

²⁴ Kadi, Abdul Fettah. *El-kiraat fi nadhri el-musteshrikine*. F. 30-34.

domethëniet e ajetit, varësisht nga leximi, ishin të sakta dhe se çdo lexim ishte pothuaj si një ajet në vete²⁵.

Si rezyme e asaj që ka përmendur Shejh Abdul Fettahi, mund të themi si dallimet në lexime janë dallime në lloj dhe ndryshim, e jo dallime që shkaktojnë mospërputhshmëri. Nëse kjo nuk mund t'i atribuohet një njeriu gjenial, atëherë si mund të thuhet kështu për Fjalën e Zotit?! Kështu, vërtetohet se është e pamundur që tekstit kur'anor t'i vishet diç e tillë. Po kështu, transmetimet e leximeve kur'anore kanë ardhur nëpërmjet rrugës më të saktë²⁶, tevaturit, që nënkupton se janë drejtpërdrejt nga i Dërguari i Allahut [*alejhis salatu ves selam*]²⁷, prej të cilit e morën sahabët [*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*] për t'ua përcjellë më pas tabiinëve, dhe kështu brez pas brezi deri tek ne.

Allahu e di më së miri!

2. DYSHIMI I DYTË DHE ZHVLEFTËSIMI I TIJ

Dyshimi i dytë ka të bëjë me atë se kinse një grup muslimanësh që kanë insistuar në unifikimin e tekstit kur'anor nuk kanë hasur në përkrahjen e të tjerëve. Tekstualisht, në librin e tij të përmendur më lart, Goldziheri thotë:

²⁵ Ibid. F. 30-34.

²⁶ Shih: Xhebel, Muhammed Hasen Hasen. *Vethakatu naksi en-nassi-l-Kur'anijj min Resulilah il ummetihi*, f. 157.

²⁷ Dijetarët janë kompaktë sa i përket asaj se kiraetet janë teukifijjeh, pra që vërtetohen vetëm me tekst fetar dhe se format e tjera nuk vlejnë. I këtij mendimi nuk ishte vetëm Zemahsheri, i cili mendon se kjo çështje është alternative. Shih: El-burhan fi ulumi-l-Kur'an, 1/321; *El-kiraat el-varidetu fi-s-sunneti ve meahu xhuz'un fihi kiraatu-n-Nebijji [sal-la Allahu alejhis ve sel-lem]* li Ebi Umer Hafs Ibn Umer ed-Durij, i autorit Ahmed Isa el-Asravi, f. 42-43.

“Në tërë periudhën e hershme të historisë islame nuk është vërejtur ambicia për unifikimin fetar (besimor) të tekstit, përveç disa raste të një përkrahje të pamjaftueshme...”²⁸

Shejhu, Allahu e pastë mëshiruar, duke zhvleftësuar këtë akuzë thotë:

Sipas këtij paragrafi, kuptohet se na paskësh qenë një grup muslimanësh që paskan shfaqur ambicie për unifikim akaidor të tekstit kur'anor, por që nuk paskësh fituar edhe përkrahjen e publikut, me përjashtim të një pakice. Kjo është një akuzë e pabazë dhe një pohim të cilin argumentet e zhvleftësojnë në tërësi. Nuk është vërtetuar se ndonjëri prej muslimanëve ka dashur apo të paktën ka menduar të bëjë unifikimin e teksteve të Kur'anit Fisnik. Ajo që në fakt ka bërë halifeja Uthman Ibn Affani [*Allahu qoftë i kënaqur me të!*] nuk ka të bëjë aspak me këtë që thotë Goldziheri. Halifeja ka synuar t'i bashkojë muslimanët rreth kiraeteve të vërtetuara në mënyrën më të saktë, pra *tevaturin*, dhe jo se ka pasur ndonjë motiv tjetër, ndryshe, siç nënvizon Shejh Abdul Fettahu, Uthmani nuk do të lejonte që në mus'hafet e shkruara në kohën e tij të kishte dallime në disa vende, dhe kjo sipas kiraeteve të ndryshme, por do të urdhëronte që të gjitha mus'hafet të shkruheshin me një formë të vetme. Pra, shkrimi i tyre në forma të ndryshe, gjithnjë në përputhje me kiraetet e vërtetuara, është dëshmi se Uthmani nuk ka pasur për qëllim unifikimin e tekstit kur'anor...²⁹

²⁸ Ignas Goldziher. *Medhahibu-t-tefsiri el-islamijj*, f. 5.

²⁹ Kadi, Abdul Fettah. *El-kiraat fi nadhri el-musteshrikine*, f. 50.

3. DYSHIMI I TRETË DHE ZHVLEFTËSIMI I TIJ

Goldziheri na e përshkruan akuzën e tij të radhës në faqen e tetë të librit të tij ‘Medhahib et-tefsir el-islamijj’, ku thotë:

‘Një pjesë e madhe e këtyre dallimeve i faturohet karakteristikës së shkrimit arab, struktura³⁰ e të cilit ofron volume të ndryshme tingujsh, sipas dallimit të pikëve të vëna sipër ose poshtë kësaj strukture, apo sipas numrit të këtyre pikave. Po kështu, edhe në rastin kur nuk ka ndryshime (dallime) në volume tingujsh, ndryshimi i vokaleve³¹, e që në shkrimin e vërtetë arab nuk ka diç që e përcakton (kufizon), bën që pozitat e trajtës së fjalës të pësojnë ndryshime, e rrjedhimisht të ndryshojnë edhe kuptimet e saj. Kësisoj, dallimi në pikësimin e strukturës së shkrimit dhe dallimi i vokaleve në kuptimin apo përmbajtjen e unifikuar, që ndryshon me ose sipas shkronjave të pazëshme, kanë qenë shkak i parë në krijimin e lëvizjes së dallimit të kiraeteve në tekstin që, realisht, nuk ka qenë i pikësuar, apo nuk është synuar preciziteti në pikësimin dhe vokalizimin e tij...’³²

Dr. Abdul Fettahu bën zhvleftësimin e kësaj akuze duke dhënë shpjegimet në vijim:

³⁰ Përkthyesi i librit në arabisht, Dr. Abdul Halim Nexh-xhar, në shënimin e tij përkitazi me këtë çështje, thotë: ‘Shkrimi arab nuk ka qenë shkak i dallimit ndërmjet këtyre leximeve, përkundrazi, me formën e vet pa pika dhe vokale gjatë kohës së shkrimit të mus’hafëve në kohën e Uthmanit, ai i ka kontribuar perceptimit të leximit autentik. Mësimi nuk merret këtu nga shkrimi...’, f. 7. Shih po kështu: *Nedharat fi ilmi-l-kiraat* të Dr. Semir Ibn Jahja el-Muabbir, f. 73-133.

³¹ Në arabisht, pikat vihen ndonjëherë për të dalluar disa shkronja nga të tjerat, si p.sh. shkronja ‘f’ ka sipër një pikë, ndërsa ‘k’-ja e fortë ka dy pika, ndërsa zanoret, që në gjuhën arabe fitohen vetëm me shenja, vihen po kështu sipër ose poshtë tyre, duke i dhënë fjalëve më pas kuptimin e caktuar. (shën. i përkth.)

³² Ignas Goldziher. *Medhahibu-t-tefsiri el-islamijj*, f. 8.

Ky, sigurisht, është një mendim i gabuar, sikurse që është një vështrim i çoroditur, pretendim i kotë dhe shpifje e urryer, gjëra për të cilat ka guxim vetëm një njeri sikur Goldziheri, dhe këtë, jo për tjetër, por vetëm që të njollosë gjënë më të shtrenjtë tek besimtarët, Kur'anin Famëlartë dhe të mbjellë dyshime dhe të shkaktojë dilema tek ata se kinse Libri i tyre nuk qenka kontrolluar, respektivisht, shprehjet, leximet dhe transmetimet e tij nuk qenkan verifikuar dhe transmetuar e bartur tek brezat e mëvonshëm me besnikëri dhe sinqeritet³³.

Fatbardhësisht, këtë mendim e zhvleftësojnë të vërtetat historike, sikurse që e sfidojnë dhe e mposhtin argumentet më të sakta fetare, në përgjithësi e në hollësi, të cilat dëshmojnë se kiraetet (leximet) kanë për bazë dhe burim shpalljen hyjnore (vahjin) dhe transmetimin e vërtetë nga i Dërguari [*alejhis salatu ves selam*] dhe se ato, në fakt, janë një traditë e përcjellë nga i fundit prej të parit, nga pasardhësit prej paraardhësve, nga i Dërguari i Allahut [*alejhis salatu ves selam*] prej Xhibrilit, e nga ky i fundit prej Allahut të Madhëruar...

Më pas, shejhu sjell edhe argumentet tradicionale dhe racionale, përmbajtjen e të cilave, si parafrazim, do e sjellim në vijim:

Historia është dëshmia më e mirë se si Kur'ani, me të gjitha leximet dhe transmetimet e tij, para se të jepej urdhri për shkrimin e tij në një Mus'haf nga Halifeja Uthman [*Allahu qoftë i kënaqur me të!*], është ruajtur përmendsh nga sahabët [*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*], madje edhe para se të bëhej shkrimi i tij në fletushka në kohën e të sinqertit, Ebu Bekrit [*Allahu qoftë i kënaqur me të!*]. Historia, po kështu, dëshmon se edhe leximet dhe transmetimet e Kur'anit janë të sakta dhe të vërteta, për faktin se, përveç të tjerash, edhe në të gjallë të Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] ato kanë qenë të përhapura në

³³ Kadi, Abdul Fettah, *El-kiraat fi nadhri el-musteshrikine*, f. 68.

mesin e njerëzve dhe se askush nuk dyshon në saktësinë dhe vërtetësinë e teksteve dhe zinxhirëve të transmetuesve (senedeve) të këtyre transmetimeve.

Në vazhdim do të përmendim disa nga këto transmetime për të dëshmuar se vërtet njeriu nuk ka gisht në to dhe se leximet nuk janë të ndryshme, pasi kjo është karakteristikë e shkrimit arab³⁴.

Dëshmia e parë: Buhariu dhe Muslimi transmetojnë në sahihët e tyre nga Ibni Abbasi [*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*] se i Dërguari i Allahut [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë:

Xhibrili [alejhis selam] ma lexonte (Kur'anin) në një germë (lexim), ndërsa unë e shqyrtova dhe kam vazhduar të kërkoj (më shumë lexime për t'ua lehtësuar besimtarëve), ndërsa ai më shtonte, derisa mbaroi tek shtatë germat (leximet)."

Dëshmia e dytë: Buhariu transmeton në sahihun e tij nga Umer Ibn Hattabi [*Allahu qoftë i kënaqur me të!*], i cili rrëfen:

Derisa ishte gjallë i Dërguari i Allahut [alejhis salatu ves selam], më ra ta dëgjoja Hisham Ibn Hakim Ibn Hizamin tek lexonte nga kaptina el-Furkan sipas leximeve të shumta, që mua i Dërguari i Allahut [alejhis salatu ves selam] nuk ma pati lexuar ashtu. Gati sa nuk e rroka për koke në namaz, por bëra durim derisa dha selam, kështu që, si e kreu namazin, e kapa për pelerinë dhe i thashë: - Kush ta ka lexuar këtë kaptinë që dëgjova tash ta lexojë (në namaz)? - Ma ka lexuar i Dërguari i Allahut [alejhis salatu ves selam], - më tha, ndërsa unë i thashë se gënjente, ngase i Dërguari i Allahut mua ma kishte lexuar ndryshe nga ajo që e kishte lexuar ai. E mora dhe e dëgjova tek i Dërguari i Allahut [alejhis salatu ves selam] dhe i thashë: - E kam dëgjuar këtë njeri të lexonte kaptinën el-Furkan jo ashtu sipas leximeve që m'i ke

³⁴ Rreth shumëllojshmërisë së kiraeteve, shih: *El-kiraat, ahkamuha ve masdaruha* të Dr. Sha'ban Muhammed Ismailit, f. 39-50.

lexuar. I Dërguari i Allahut [alejhis salatu ves selam] më tha: - Lëshoje, - ndërsa atij i tha: - Lexo o Hisham! Hishami ia lexoi leximin të cilin e dëgjova më parë ta lexonte (në namaz). I Dërguari i Allahut [alejhis salatu ves selam] tha: -Kështu është shpallur. Më pastaj tha: -Lexo o Omer! - ndërsa unë lexova leximin që ai ma pati lexuar. I Dërguari i Allahut tha: -Kështu është shpallur. Vërtet – shtoi, - ky Kur'an është shpallur në shtatë lexime, andaj lexojeni atë që iu është lehtësuar prej tij!"

Hafidh Ibni Haxher Askalaniu, në Fet'hu-l-Bari, ka thënë:

"Shkaku pse polemizuan Omeri dhe Hishami ishte se Omeri e kishte dëgjuar leximin e kaptinës më përpara se të dëgjonte hadithin e shpalljes së Kur'anit në shtatë germa (lexime), hadith të cilin e dëgjoi vetëm pas kësaj ndodhie."

Dëshmia e tretë: Ubejj Ibn Ka'bi [Allahu qoftë i kënaqur me të!] rrëfen se:

Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] ishte tek Edati Beni Gifari ku i erdhi Xhibrili [alejhis selam] dhe i tha: Vërtet, Allahu të urdhëron që t'ia lexosh Kur'anin ummetit tënd sipas një germe (leximi)! Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] tha: E lus Allahun për ndjesë dhe falje, por ummeti im nuk mund ta përballojnë një gjë të tillë! Pastaj i erdhi për herë të dytë dhe i tha: Vërtet, Allahu të urdhëron që t'ia lexosh Kur'anin ummetit tënd sipas dy germave (leximeve)! Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] tha: E lus Allahun për ndjesë dhe falje, por ummeti im nuk mund ta përballojnë një gjë të tillë! Pastaj erdhi për të tretën herë dhe tha: Vërtet, Allahu të urdhëron që t'ia lexosh Kur'anin ummetit tënd sipas tri germave (leximeve)! Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] tha: E lus Allahun për ndjesë dhe falje, por ummeti im nuk mund ta përballojnë një gjë të tillë! Pastaj erdhi për të katërtën herë dhe tha: Vërtet, Allahu të urdhëron që t'ia lexosh Kur'anin ummetit tënd sipas shtatë germave (leximeve) ndërsa ata, sipas cilësdo germë (cilit do lexim) të lexojnë, ia kanë qëlluar!"

Shejhu Abdul Fettah sjell dhe argumente të tjera, që dëshmojnë po kështu se leximet janë çështje të përcaktuara fetarisht, që nuk ndryshojnë dot (ar. teukifijeh) dhe se referencë për to është i Dërguari i Allahut [*alejhis salatu ves selam*], i cili i transmeton ato nga Xhibrili [*alejhis selam*] e ky nga Allahu i Lartësuar.

Përveç kësaj që përmendëm, lënda el-Ikra (lexim) është përsëritur në hadithe, gjë që dëshmon se leximet janë vërtetuar sipas mënyrës tradicionale (shpalljes) dhe se ato janë marrë e transmetuar gojarisht, sikurse që sahabët [*Allahu qoftë i kënaqur me ta!*] kanë qenë jashtëzakonisht të kujdesshëm sa i përket shprehjeve të Kur'anit dhe zotërimit të fjalëve dhe shkronjave (germave) të tij. Konsideroj se argument më të mirë, për çështjen në fjalë, se sa rasti i Omer Ibn Hattabit me Hisham Ibn Hakemin nuk na duhet.

Shejh Abdul Fettahu sjell dhe argumente racionale për të zhvleftësuar teorinë e Goldziherit. Ai thotë se kur Halifeja Uthman Ibn Affani dërgoi ekzemplarët e Kur'anit nëpër vendet islame, dërgoi po kështu edhe dijetarë që t'ua mësonin njerëzve Kur'anin sipas Mus'hafit të dërguar dhe sipas asaj që ai parasheh. Kështu, Zejd Ibn Thabitin e dërgoi lexues në Medinë, Abdullah Ibn Saibin në Mekë, Mugire Ibn Shihabin në Sham, Amir Ibn Abdu Kajsin në Basra dhe Ebu AbduRrahman Selemiun në Kufe. Secili prej këtyre dijetarëve ua lexonte Kur'anin banorëve vendas sipas leximit mutavatir (më të saktë të mundshëm) të cilin e kishte mësuar nga i Dërguari i Allahut [*alejhis salatu ves selam*] dhe që figuronte në shkrimin e Mus'hafit, pa u ndaluar fare tek leximet e tjera, që nuk ishin vërtetuar saktësisht, edhe nëse shkrimi i Mus'hafit mund t'i përmbante figurativisht ato. Kësisoj, qëllimi i dërgimit të një lexuesi me një kopje të Kur'anit ishte që leximi të mos dilte jashtë suazave të llojit të vërtetuar sipas mënyrës më të saktë – *mutevatir*, ndryshe, do të krijohej mundësia që kushdo ta

lexonte Kur'anin si të donte, pavarësisht nëse leximi i tij ishte vërtetuar apo jo. Por jo, Uthmani dërgoi lexues që t'ua mësonin njerëzve leximet, jo të vërtetuara sipas shkrimit, por sipas traditës³⁵. Pastaj, shejhu vazhdon me shpjegime shtesë dhe thotë: Në Kur'an ka fjalë që janë përsëritur në disa vende dhe që në të gjitha rastet janë shkruar me një shkrim, por në disa vende kanë ardhur forma të leximit që i përmban shkrimi, kështu që lexuesit kanë polemizuar ndërmjet vete dhe për pasojë kemi lexime të ndryshme për to. Në raste të tjera, lexuesit janë pajtuar për leximin e tyre vetëm sipas një versioni, për shkak se versionet e tjera nuk janë vërtetuar me traditë, edhe pse shkrimi mund t'i përmbajë këto të fundit. P.sh.: fjala 'Malik' (ar. مالِك) është përmendur tri herë në Kur'an si mbiemër apo në cilësinë e tij:

1. *Sunduesit të Ditës së Gjykimit (përgjegjësisë-shpërblimit)!"* (el-Fatiha, 4)

2. *Thuaj: "O All-llah, Sundues i çdo sendi..."* (Ali Imran, 26)

3. *Sunduesin e njerëzve."* (en-Nas, 2)

Në të tri rastet, kjo fjalë është shkruar njëlloj, pra në të tri herët elifi (ar. ا) nuk figuron fare, por lexuesit kanë polemizuar vetëm rreth formës së leximit në rastin e parë, pra në ajetin e Fatihasë³⁶. Disa e kanë lexuar me elif (malik مالِك) e të tjerë pa të (melik مَلِك), ndryshe nga rasti i dytë, pra ai në kaptinën Ali Imran, që, edhe pse ka hapësirë

³⁵ Kadi, Abdul Fettah. *El-kiraat fi nadhri el-musteshrikine*, f, 78-120.

³⁶ Rreth ndikimit të leximeve kur'anore në dispozitat dhe shkencat fetare, shih: Al Ismail, Nebil Ibn Muhammed Ibrahim, *Ilmu-l-kiraat – nesh'etuhu, atvaruhu, etheruhu fi-l-ulum esh-sher'ijeh*, f. 70; 223; 365.

sipas rregullave gjuhësore të lexohet pa elif, madje as kuptimi nuk do t'i humbte, megjithëkëtë, për shkak se nuk ka ndonjë transmetim autentik që vërteton se bën të lexohet pa elif, askush nuk e ka bërë këtë, dmth: është lexuar (مالك)

Kjo, sigurisht se nëse flet për diç, atëherë flet për përkushtimin madhor që kanë pasur ata transmetues për Kur'anin Famëlartë. Këtë mund ta vërejmë edhe në rastin e tretë, për të cilin transmetuesit nuk kanë polemizuar se duhet të lexohet pa elif, edhe pse gjuhësisht do t'iu lejohej një gjë e tillë. Këtë nuk e kanë bërë për shkak se nuk kanë pasur argument që vërteton leximin edhe me *elif*.

Përfundim

Në përfundim të këtij referimi shkencor do të donim të vërtetonim atë që thotë shejhu [*Allahu e mëshiroftë!*] se kiraetet (leximet) nuk janë çështje alternative dhe se nuk janë produkt i ixhtihadit (punës shkencore). Po kështu, as diversiteti i tyre nuk është për shkak të shkrimit dhe formës. Përkundrazi, është sipas sunnetit, transmetimit dhe bartjes gjeneratë pas gjenerate. Sigurisht, shpifjet dhe akuzat e orientalistëve e humbin kredibilitetin shkencor përpara këtij realiteti shkencor dhe objektiv të të vërtetave islame. Në përmendëm vetëm disa nga fjalët që shejhu ka thënë në këtë drejtim, ndërsa të tjerat nuk mund t'i përmendim për shkak të natyrës së këtij punimi, i cili nuk na lejon të zgjerohemi më shumë.

Prej atyre të vërtetave të padiskutuara është edhe ajo se Kur'anit është marrë (mësuar) sipas metodës verbale dhe asaj dëgjimore të zërit të drejtpërdrejtë, me të cilën rëndom kuptohet:

- 1) Dëgjim i zërit nga Xhibrili [*alejhiselam*]
- 2) Dëgjim i zërit nga i Dërguari i Allahut tek shkruesit e Kur'anit, së pari, e më pas edhe tek të gjithë muslimanët
- 3) Dëgjim i zërit nga shkruesit e Kur'anit tek popullata masive e muslimanëve
- 4) Dëgjim i zërit nga hafëzët tek ata që e mësojnë prej tyre³⁷.

E lus Allahun e Madhëruar që këtë vepër modeste ta pranojë sinqerisht prej meje dhe që të mos i privojë studentët dhe kërkuesit e dijes prej mirësive dhe bereqetit të saj!

Dr. Hajredin Hoxha

Brunei Darussalam, 2010

Fakulteti Usulud-din-Sultan Sherif Ali Islamic University

³⁷ Për më shumë rreth këtyre çështjeve, kthehu tek portalet: www.rudood.com & www.dar-alifta.org

Literatura:

1. Kur'ani i Madhërishëm.
2. Al Humejd, Sa'd. *Ahdafu el-istishraki ve vesailuhu*. Xhamiatu el-Meliki Suuud.
3. Al Ismail, Nebil Ibn Muhammed Ibrahim. (?) *Ilmu-l-kiraat – nesh'etuhu, atvaruhu, etheruhu fil ulumi-sh-sherijjeti*. Rijad: Mektebetu-t-Teubeh.
4. Bazmul, Muhammed Ibn Omer Ibn Salim. (1996) *El-kiraat ve etheruha fi-t-tefsiri ve-l-ahkam*. Rijad: Darul Hixhrehli-n-nehsri ve-t-tevzië.
5. Ebu Shehbe, Muhammed. (1989) *Difaun ani-s-sunneti ve reddu shubehi-l-musteshrikine ve-l-kuttabi-l-muasirine – ve jelihi err-rreddu ala men jenkuru huxh-xhijjeti-s-Sunneh li-l-Al-lameti Abdul Gani Abdul Halik*. Mektebetu-s-Sunneh.
6. Ismail, Sha'ban Muhammed. (1402 h.) *El-kiraat, ahkamuha ve mesadiruha*. Mekke el-Mukerreme.
7. Benna, Ahmed Ibn Muhammed. *It'hafu fudalai-l-besher bi-l-kiraati erbeati asher – el- musemma Muntehel emani vel meserat fi ulumil kiraat*. Mektebetu el-kul-lijjat el-ez'herijje.
8. El-Bejli, Ahmed. (?) *El-ihtilafu bejnel kiraat*. Hurtum: Ed-dar es-sudaniije lil kutub.
9. Goldziher, Ignas. (1992) *Medhahibu-t-tefsiri-l-islamijj*. Bejrut: Dar Ikre.
10. Xhebel, Muhammed Hasen Hasen. (2002) *Err-rreddu alel musteshkrikil jehudijj Goldziher fi metainihi alel kiraat el-kuraniijeh*. El-Ez'her: Kul-lijjetu el-Kur'anil Kerim.
11. Xhebel, Muhammed Hasen Hasen. (?) *Vethakatu nakli-n-nassi-l-kur'anijj min Resulillahi ila ummetihi*. Egjipt: Daru-s-Sahabeh li-t-turath.
12. El-Xhezriij, Ebu-l-Hajr Muhammed Ibn Muhammed. (?) *En-neshru fi-l-kiraat el-ashr li-l-Hafidh m.s. 833*. Bejrut: Daru-l-kutub el-ilmijeh.
13. Raxhihi, Abduhu. (1999) *El-lehexhat el-arabijeh fi-l-kiraat el-kur'anijeh*. Rijad: Mektebetu-l-mearif.

14. Zerkeshi, Bedruddin. (1400 h.) *El-burhan fi ulumi-l-Kur'an*. Kajro: Mektebetu Vehbe.
15. Zakzuk, Mahmud Hamdi. (1404) *El-istishrak ve-l-halfijjetu el-fikrijjetu li-s-sirai-l-hadarij*. Kitabu-l-ummeh.
16. Sasi, Salim el-Haxh. (2002) *Nakdu-l-hitabi-l-istishrakijj – edh-dhahiretu el-istishrakijjetu ve etheruha fi-d-dirasat el-kur'anijjeh*. Bengazi: Daru-l-medari-l-islamijj.
17. El-Buharij. (1410 h.) *Sahihu-l-Buharij*. Bejrut: Daru-l-fikr.
18. Sahihu Muslim bi sherhi-n-Nevevijj. Bejrut: Daru-l-fikr.
19. Taberijj, Muhammed Ibn Xherir. (1420) *Xhamiu-l-bejan fi te'vili aji-l-Kur'an*. Mektebetu el-ulum ve-l-hikem.
20. Kadi, Abdul Fettah. (1408) *El-kiraat fi nadhri el-musteshrikine*. Medine: Mektebetu ed-Dar.
21. Kadi, Abdul Fettah. (1408) *El-budur ez-zahireh fi-l-kiraat el-ashr el-mutevatire min tarikat esh-shatibijjeh ve-d-durr-rreh*. Medine: Universiteti Islamik.
22. El-Kattan, Mennaë. (1991) *Nuzulu-l-Kur'ani ala seb'ati ahrufin*. Kajro: Mektebetu Vehbe.
23. Muhajsin, Muhammed Salim. (1978) *El-muhedh-dheb fi-l-kiraat el-ashr ve tevxihiuha*. Kajro: Mektebetu kul-lijjati-l-ez'herijjeh.
24. El-Muabbir, Semir Ibn Jahja. (2005) *Nedharat fi ilmi-l-kiraat*. Xhidde: Hafidh.
25. El-asravi, Ahmed Isa. (2006) *El-kiraat el-varidetu fi-s-sunneti ve meahu xhuz'un fihi kiraatu-n-Nebijji [sal-la Allahu alejhis ve sel-lem] li Ebi Umer Hafs Ibn Umer ed-Durij*. Kajro: Daru-s-selam.
26. Vezan, Adnan Muhammed. *El-istishrak ve-l-musteshrikune – vixhhetu nadhrin*, botim i Ligës Islame, nr. 24, 1404.
27. www.uqu.edu.sa
28. www.maroc-quran.com/vb/t4252.html
29. www.ahlalalm.org/vb/showthread.php?p=164354
30. www.mazameer.com/vb/t9868.html
31. www.rudood.com
32. www.dar-alifta.org